



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI

Nr. 921/2 Prot.

Tiranë, më 24.06.2026

V E N D I M

Nr. 174, Datë 24.06.2026

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar¹, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 123, datë 15.05.2026, e paraqitur nga znj. V.D kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), në të cilën pretendon se është diskriminuar “çdo shkak tjetër”².

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit, ankuesja V.D (L), nëpunëse civile pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD), i është drejtuar Komisionerit me një ankesë në të cilën pretendon se transferimi i saj nga pozicioni i përgjegjëses së Sektorit të Legjislacionit dhe Përafrimit me BE-në, në DPD dhe transferimi në Degën Doganore Fier, përbëjnë trajtim diskriminues dhe viktimizim në marrëdhëniet e punës, bazuar në ligjin nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Sipas ankueses, ngjarjet kanë filluar më datë 15.04.2026, kur në një mbledhje të zhvilluar nga drejtori i DPD-së, z. B.B, ky i fundit ka kërkuar verbalisht që në projekt-vendimin për ndryshimin e VKM Nr. 651/2017 (lidhur me plumbçet elektronike/GPS) të parashikohet një shoqërie e caktuar si operator i vetëm me të drejta ekskluzive, me synim shmangien e ligjit të prokurimit publik. Ankuesja pretendon se është shprehur kundër kësaj kërke, duke vënë në dyshim ligjshmërinë e

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja në kuadër të “çdo shkak tjetër” është: “reagimi ndaj qëndrimit profesional dhe juridik të mbajtur gjatë ushtrimit të detyrës në kundërshtim me titullarin.”

ekskluzivitetit, ndërsa z. Beja i është kundërpërgjigjur në mënyrë autoritare, duke i thënë se “është autoriteti im këtu dhe jo autoriteti yt”.

Ankuesja informon se, Sektori i Legjislacionit, i drejtuar prej saj, ka përgatitur më pas një relacion me argumente juridike kundër ekskluzivitetit. Më datë 17.04.2026, në një mbledhje *online*, kur ankuesja e ka informuar titullarin se sektori kishte përgatitur këto argumente juridike, ai ka reaguar duke pyetur “*Kush të ka kërkuar argumenta juridike?*” dhe e ka nxjerrë nga mbledhja.

Ankuesja pretendon se më datë 20.04.2026, në orën 09:05, i ka dorëzuar dorazi sekretares së titullarit projekt-vendimin, relacionin shpjegues dhe relacionin me qëndrimin juridik kundërshtues. Vetëm dhjetë minuta më vonë, në orën 09:15 të të njëjtës ditë, i është dorëzuar urdhri i transferimit, Urdhri nr. 7693 Prot., datë 20.04.2026, me të cilin është larguar nga pozicioni i Përgjegjës së Sektorit dhe është transferuar në pozicionin “Specialist/jurist borxhi” në Degën Doganore Fier, mbi 130 km larg vendbanimit të saj në Tiranë, me mbi 250 km udhëtim ditor vajtje-ardhje.

Ankuesja deklaron se, më datë 24.04.2026 e ka kundërshtuar urdhrin e transferimit pranë DPD-së, por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Ajo pretendon gjithashtu se rreth dy javë pas largimit të saj, Drejtoria e Apelit, Ankimeve Doganore dhe Përafrimit me BE-në i ka përcjellë zyrtarisht titullarit një memo me të njëjtin qëndrim juridik që vetë ankuesja kishte paraqitur më 20.04.2026, pikërisht në momentin kur praktika do t’i dërgohej Ministrisë së Financave.

Ankuesja pretendon se është viktimizuar në kuptim të nenit 2, pika 17 dhe nenit 5, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrotjen nga Diskriminimi*”, pra se, ndëshkimi i saj është pasojë e “*reagimit ndaj qëndrimit profesional dhe juridik të mbajtur në kundërshtim me titullarin*”. Ajo argumenton gjithashtu se, transferimi është masë disproporcionale, e marrë pa analizë alternativash, pa mbulim shpenzimesh, pa afat të përcaktuar dhe pa mundësi dëgjimi paraprak (shkelje e neneve 87, 99, 100 të KPA dhe nenit 48 pika 3 shkronja “b” të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”), si dhe se pozicioni i ri është jashtë profilit të saj profesional, me ulje funksionale dhe ekonomike (shkelje e neneve 1, 5, 33, 48/1/a të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*” dhe neneve 13, 15/7/a/i të Kodit Doganor). Si elementë shtesë të efektit diskriminues, ankuesja përmend se është grua, 50-vjeçare, nënë e dy fëmijëve me përgjegjësi familjare, dhe se ka probleme shëndetësore lidhur me udhëtimin, duke ngritur pyetjen nëse ka punonjëse të tjera në DPD në kushte të ngjashme që i nënshtrohen një trajtimi të tillë.

Sa më sipër, ankuesja kërkon nga Komisioneri konstatimin se transferimi i saj nga pozicioni i përgjegjës së Sektorit të Legjislacionit dhe Përafrimit me BE-në, në DPD dhe transferimi në Degën Doganore Fier përbën trajtim diskriminues, viktimizim dhe ushtrim disproporcional e arbitrar të pushtetit administrativ. Ankuesja kërkon vendosjen e masave korrigjuese, rekomandimin për kthimin e saj në pozicionin e mëparshëm, si dhe marrjen e masave për ndalimin e çdo forme tjetër viktimizimi ndaj saj.

II. Procedura e ndjekur nga Komisioneri për shqyrtimin e ankesës

Në kuadër të shqyrtimit paraprak, Komisioneri konstatoi se, ankesa kishte mangësi të anës formale, në lidhje me provueshmërinë e shkakut të pretenduar të diskriminimit.

Nëpërmjet *e-mail-it* të datës 29.05.2026, Komisioneri kërkoi nga ankuesja, plotësimin e ankesës, me informacion në lidhje me faktin nëse ajo dispononte ndonjë reagim ose përgjigje në lidhje me memon me mendimin juridik, të përgatitur nga Sektori i Legjislacionit të dërguar me *e-mail* në datën 17.4.2026 në adresë të Drejtores së Drejtorisë së Apelimit, Ankimimeve Doganore dhe Përafrimit me BE-në, ku ajo ushtronte detyrën e përgjegjëses së sektorit dhe nëse ishin marrë masa ndëshkuese ndaj punonjësve të tjerë në Sektorin e Legjislacionit, të cilit ishin përfshirë në përgatitjen e memos.

Në përgjigje të kërkesës për plotësimin e ankesës, pala ankuese ka depozituar parashtimet e saj plotësuese, nëpërmjet *e-mailit* të datës 04.06.2026, ku ndër të tjera shprehet se:

Në dijeninë e saj, nuk janë dhënë masa administrative ndaj punonjësve të tjerë të Sektorit të Legjislacionit që kanë hartuar memon. Ankuesja deklaroi gjithashtu se, dy javë pas transferimit të saj, është bërë me dije se, Drejtoria e Apelimit, Ankimimeve Doganore dhe Përafrimit me BE-në, ku ajo ushtronte detyrën e Përgjegjëses së Sektorit, i ka përcjellë zyrtarisht titullarit një memo, ku është mbajtur i njëjti qëndrim juridik me mendimin e depozituar nëpërmjet *e-mailit* të datës 17.04.2026, por ky dokument nuk disponohet nga ana e saj por gjendet pranë DPD. Ankuesja thekson se, në javën që ka ndodhur ngjarja, përfshirë datën 17.04.2026, dhe në javën vijuese, eprorja e saj e drejtpërdrejtë, drejtoresha e Drejtorisë së Ankimit, Apelimeve dhe Përafrimit të Legjislacionit me BE-në, ka qënë me leje të zakonshme.

- *Vlerësimi i Komisionerit*

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Ky parim presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta dhe vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme e objektive mund të përliqet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë (Vendimet nr. 31 datë 04.10.2021, nr. 27, datë 29.06.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 10, datë 29.02.2016; nr. 48, datë 15.11.2013 të Gjykatës Kushtetuese).

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke sanksionuar parimin e barazisë para ligjit, nuk i ka dhënë atij kuptimin e një të drejte absolute, sepse ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kushtet e

kufizimit në ushtrimin e kësaj të drejte. Paragrafi i tretë i nenit 18 të Kushtetutës pranon kufizimet e të drejtës për barazi me përmbushjen e disa kushteve të posaçme, pikërisht të përligjjes së arsyeshme dhe objektive. (Vendimi nr. 19, datë 09.07.2009 i Gjykatës Kushtetuese). Ky parim kërkon që të gjitha subjektet të trajtohen në mënyrë të njëjtë, por nuk formulon ndalime që të mund të bëhen trajtime të diferencuara kur individët e grupet nuk ndodhen në kushte të njëjta a të ngjashme, apo kur ka justifikim të arsyeshëm e objektiv, duke vendosur një raport të arsyeshëm dhe përpjesëtimor midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të arrihet. (Vendimet nr. 18, datë 29.07.2008 dhe nr.19, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe sesa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet³.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁴. Referuar jurisprudencës së GJEDNJ-së, diskriminimi i drejtpërdrejtë, edhe pse neni 14 i KEDNJ-së nuk jep një përkufizim të tij, konsiderohet si “dallim në trajtim i personave në situata të njëjta ose të ngjashme” dhe “bazuar në një karakteristikë ose “status” të dallueshëm”⁵.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me një listë të hapur shkaqesh, duke sanksionuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

³ Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

⁴ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24.10. 2019.

⁵ Shih: Biao kundër Danimarkës, Dhoma e Madhe, datë 14.05.2016, § 89, Carson dhe të Tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, Dhoma e Madhe 2010, datë 16.03.2010, prg. 61.

Bazuar në nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar (LMD), diskriminimi përcaktohet si : “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*”

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji. Për të pasur një pretendim për diskriminim, duhet domosdoshmërisht që të identifikohet një shkak, i cili në bazë të ligjit është i ndaluar ose i mbrojtur. Shkakut i diskriminimit përbën një nga elementët thelbësor për të paraqitur një pretendim për diskriminim.

Si rregull, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë *në radhë të parë* se, shkakut i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe *në radhë të dytë* duhet të provojë ekzistencën e tij.

Shkakut i pretenduar i diskriminimit nuk duhet vetëm të konsiderohet si shkak i mbrojtur sipas ligjit, por duhet të provohet se pala ankuese e mbart këtë shkak, dhe se detyrimi për të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit i takon palës ankuese. Kjo qasje ndaj barrës së provës është e domosdoshme, pasi Komisioneri nuk mund të hetojë mbi baza abstrakte apo thjesht supozimet e palës ankuese. Duhet të ekzistojë një minimum informacioni faktik dhe provues që lidh trajtimin e pretenduar të pafavorshëm me një shkak të mbrojtur konkret.

Nga shqyrtimi i ankesës dhe i parashtrimeve plotësuese të paraqitura nga ankuesja, Komisioneri konstaton se pala ankuese pretendon se është diskriminuar për shkak të “refuzimit për të zbatuar urdhra që bien ndesh me ligjin”. Shkakut i pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi, nuk parashikohet shprehimisht nga neni 1 i LMD.

Neni 1, i LMD, liston disa shkaqe, megjithatë kjo listë nuk është e mbyllur por ilustruese, fakt ky që rezulton nga përfshirja në këtë listë e shprehjes për “*çdo shkak tjetër*”. Thënë kjo, nuk presupozon se, termi “*çdo shkak tjetër*” përbën një shkak në vetvete. Rregullimi i bërë nga neni 1, i LMD-së nëpërmjet termit “*çdo shkak tjetër*” mundëson mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe të tjera, përveç shkaqeve të listuara shprehimisht në këtë dispozitë të ligjit, por duke identifikuar “*shkakun*” i cili pretendohet se gëzon mbrojtje në kuadër të termit “*çdo shkak tjetër*”.

LMD, por edhe legjislacioni ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi, nuk ka parashikime ose përkufizim se çfarë është shkaku i mbrojtur. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, objektive ose personale, ose "status", me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri.⁶

Nga aktet e administruara, pavarësisht se ankuesja e paraqet qëndrimin juridik në lidhje me VKM-në si një qëndrim juridik, i cili vjen në kundërshtim me qëndrimin e titullarit të institucionit, një pretendim i tillë nuk bazohet në asnjë indicie, fakt ose provë.

Për më tepër, i njëjti qëndrim juridik nuk është hartuar vetëm nga ankuesja, por nga Sektori i Legjislacionit, pra edhe nga punonjës të tjerë, pavarësisht se ankuesja ka ushtruar detyrën e Përgjegjëses së Sektorit. Po ashtu, i njëjti qëndrim, sikurse deklaroi edhe vetë ankuesja, është depozituar edhe nga ana e drejtores së drejtorisë. Asnjë nga personat e tjerë nuk rezultoi se kanë pasur pasojë negative si pasojë e të njëjtit qëndrim juridik.

Nga parashtrimet e ankesës dhe dokumentacioni i depozituar bashkëlidhur saj, si dhe nga parashtrimet plotësuese të paraqitura pas kërkesës së Komisionerit, nuk rezultoi asnjë provë apo indicie, e cila provon pretendimin e ankueses në lidhje me shkakun e diskriminimit.

Komisioneri thekson se, bazuar në faktet dhe rrethanat e çështjes, kemi të bëjmë me një konflikt ose mosmarrëveshje brenda marrëdhënies hierarkike të punës, lidhur me përmbajtjen e një akti administrativ, ku ankuesja pretendon se ka pësuar pasojë negative (largim/transferim) si rezultat i kundërshtimit profesional. Kjo situatë, edhe nëse vërtetohet plotësisht ashtu si e përshkruan ankuesja, përshtatet më shumë me kategori të tjera ligjore, si abuzim me pushtetin, diskrecionin administrativ, shkelje të garancive procedurale të nëpunësit civil (e drejta për t'u dëgjuar, proporcionaliteti).

Bazuar në standardet e sipërcituara të vendosura nga GJEDNJ, por edhe nga faktet dhe rrethanat konkrete të çështjes, Komisioneri vlerëson se, shkaku i diskriminimit i pretenduar nga ankuesja *“reagimi ndaj qëndrimit profesional dhe juridik të mbajtur gjatë ushtrimit të detyrës në kundërshtim me titullarin”*, pretendim ky i ngritur në kuadër të parashikimit *“çdo shkak tjetër”*, sipas nenit 1, të LMD-së, nuk përbën shkak të mbrojtur në kuptim të ligjit.

Shkaku i diskriminimit, nuk mund të supozohet apo nënkuptohet. Ai duhet të identifikohet dhe provohet, qoftë edhe përmes provave indirekte apo indiciesh të besueshme. Në rastin konkret, Komisioneri nuk disponon asnjë informacion faktik apo provues, qoftë edhe në formën e indicieve

⁶ Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

që të lejojë identifikimin e shkakut të mbrojtur të diskriminimit dhe hetimin e mëtejshëm nëse trajtimi i pretenduar si i pafavorshëm është pasojë e atij shkakut.

Mungesa e informacionit të mjaftueshëm në lidhje me shkakun e mbrojtur të diskriminimit e bën të pamundur fillimin e hetimit dhe vazhdimin e shqyrtimit të ankesës në fazat e mëtejshme procedurale. Nëse Komisioneri do të vijonte hetimin pa u provuar shkakun i mbrojtur, kjo do të sillte transformimin e rolit të tij institucional nga organ hetimi i diskriminimit në organ që shqyrton ligjshmërinë, funksion ky i cili i takon organeve të tjera dhe gjykatës.

Komisioneri vlerëson se, cilësimi që ankuesja i bën situatës së vet si "viktimizim" në kuptimin e nenit 3, pika 17, të LMD-së, është juridikisht i pabazuar. Viktimizimi sipas kësaj dispozite, është trajtim i disfavorshëm ose pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi, që synon zbatimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas parashikimeve të nenit 1 dhe nenit 2 të këtij ligji, lidhur me pretendimin për diskriminim. Ankuesja në këtë rast nuk ka paraqitur më parë asnjë ankesë për diskriminim apo procedurë sipas LMD-së në mënyrë që të ngrejë pretendimin se trajtimi i disfavorshëm ose pasojat negative të pretenduara i kanë ardhur për këtë arsye. Ankuesja ka shprehur një qëndrim juridik profesional brenda detyrës, duke pretenduar se ky qëndrim i saj ka qenë kundër një propozimi të titullarit, në kuadër të punës së saj të zakonshme si përgjegjëse sektori.

Komisioneri thekson se, elementët e gjinisë, moshës, gjendjes shëndetësore dhe përgjegjësi familjare të përmendura nga ankuesja nuk përbëjnë shkaqe të mbrojtura diskriminimi në kuptim të nenit 1 të LMD-së, pasi nga vetë parashtrimet e ankesës rezulton se ato trajtohen si pasoja dhe rrethana përkeqësuese të masës së transferimit, dhe jo si arsye ose motiv mbi të cilën është marrë vendimi i transferimit. Shkakun i vetëm i pretenduar mbetet *“reagimi ndaj qëndrimit profesional dhe juridik të mbajtur gjatë ushtrimit të detyrës në kundërshtim me titullarin”*, i cili, siç u analizua më sipër, nuk përbën shkak të mbrojtur sipas këtij ligji.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “ç” të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“4. Ankesa nuk pranohet nëse: ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim;”* Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesja V.D nuk mund të pranohet, pasi nuk ka informacion të mjaftueshëm në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit për të bërë të mundur një hetim. Në kushtet kur ankesa nuk përmbush kriteret ligjore, ajo nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, nenin 33, pika 4, gërma “ç” të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 123, datë 15.05.2026, të paraqitur nga znj. V.D kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, për arsye se nuk përmbushen kushtet ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, konkretisht mungesa e informacionit të mjaftueshëm në lidhje me shkakun e mbrojtur të diskriminimit.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim